



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 76, datë 22.04.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Vendimin Nr.64, datë 15.04.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”” i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Zoti Kujtim Basha**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, të caktohet përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Zoti Kujtim Basha do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, nga data 01.05.2022 – 31.07.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kujtim Basha, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm zoti Kujtim Basha do të përfitojë pagën e prokurorit të apelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 22.04.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
MIRELA BOGDANI